

RAPORT NGA GRUPI I AUDITIMIT SOCIAL PEJË

PROJEKTI I MONITORUAR RREGULLIMI I PARKUT KARAGAÇ



RAPORT NGA GRUPI I AUDITIMIT SOCIAL PEJË

PROJEKTI I MONITORUAR RREGULLIMI I PARKUT KARAGAQ

Opinionet e shprehura në këtë raport nuk i përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Zyres së Bashkimit Evropian në Kosovë, Qeverive të Zvicrës, Suedisë, Norvegjisë e as të HELLETAS Swiss Intercooperation.

PËRMBAJTJA

7	Rreth DEMOS
7	Rreth Platforma CiviKos
8	Auditimi Social: Pse mbështetet nga DEMOS dhe çfarë ka për qëllim?
9	Hyrje
10	Përmbledhje Ekzekutive
12	Rreth Auditimit Social
13	Hapat e Procesit të Auditimit Social
13	Metodologjia
13	Përzgjedhja e Projekteve dhe Komunave
16	Procesi i Auditimit Social në Komunën e Pejës
16	Themelimi i Grupit të Auditimit Social në Pejë
16	Takimet e Rregullta të Grupit të Auditimit Social në Pejë
17	Qëllimi Specifik i Grupit të Auditimit Social në Pejë
17	Kërkesat për informacion/dokumente dhe pyetjet e dërguara nga Grupi i Auditimit Social në Pejë të Komunave të Pejës
18	Rreth Projektit
19	Gjetjet Kryesore
21	Rekomandimet
22	Lista e Përbërjes së Grupit të Auditimit Social

Rreth **DEMOS** Decentralisation and Municipal Support

Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje të Komunave (DEMOS), është projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) bashkëfinancuar nga Suedia dhe Norvegjia, dhe zbatuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation-Kosovo.

DEMOS përkrahë të gjitha komunat e Kosovës për të sjellë ndryshime sistemike që nxisin qeverisjen e mirë, dhe ofrimin e shërbimeve më të mira që ndikojnë pozitivisht në jetën e përditshme të qytetarëve.

DEMOS III ka për objektive të përgjithshme përmirësimin e performancës së komunave në qeverisje, menaxhim dhe shërbime, për të kontribuar në rritjen e kënaqësisë së qytetarëve.

Rreth platforma **CIVIKOS**

Platforma CiviKos është një iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, e themeluar për të krijuar dhe promovuar një mjedis të përshtatshëm për bashkëpunim formal dhe të strukturuar në mes të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore në Kosovë.

Në rritje të vazhdueshme dhe aktualisht me rreth 300 organizata anëtare të shoqërisë civile, Platforma CiviKos është e përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatave anëtare, autoriteteve publike, dhe palëve të tjera të interesuara në zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë. Me misionin e saj për të mundësuar një mjedis të favorshëm të shoqërisë civile në Kosovë, dhe anëtarësisë së saj në të gjitha rajonet e Kosovës, Platforma CiviKos vazhdon që të angazhohet në mënyrë aktive, në mbështetjen e anëtarëve të saj që veprojnë në nivel lokal dhe promovimin e pjesëmarrjes demokratike në nivel lokal.

AUDITIMI SOCIAL:

Pse mbështetet nga DEMOS dhe çfarë ka për qëllim?

DEMOS përkrahë komunat në bazë të performancës së tyre, duke përdorur Grantin e Performancës si mjet kryesor të saj. Sa më e mirë të jetë performanca e komunës, aq më e lartë është shuma e grantit. Performanca komunale vlerësohet përmes Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale (SMPK) të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Duke zhvilluar konkurrencën pozitive në mes të komunave, granti i performancës rrjedhimisht nxitë ndryshime pozitive në sjelljen e komunave për përmirësimin e qeverisjes demokratike, menaxhimit financiar dhe burimeve njerëzore, transparencës dhe integritetit.

Përveç Grantit të Performancës, DEMOS ofron asistencë teknike për stafin komunal që i fuqizon ata për të dhënë rezultate më të mira. Asistenca teknike ofrohet në fushat ku performanca konsiderohet të jetë më e dobët.

DEMOS gjithashtu përkrahë qeverinë qendrore në politikat sistemike, për një kornizë më të favorshme për qeverisje të decentralizuar.

Sipas komponentës së parë të projektit, DEMOS III synon të hapë të dhënat për një shqyrtim më të gjerë publik mbi performancën komunale dhe të inicojë auditime sociale për të monitoruar ndikimin e projekteve të Grantit të Performancës Komunale (MPG) tek qytetarët.

Qëllimi i kësaj ndërhyrjeje është të përfshijë organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët në kryerjen e auditimeve sociale për të monitoruar projektet e Grantit të Performancës Komunale (MPG) të zbatuar nga komunat.

Për të zbutur rreziqet e besueshmërisë së fondeve të Grantit të Performancës, dhe njëkohësisht për të monitoruar ndikimin e projekteve tek qytetarët, DEMOS ka vendosur auditime sociale brenda Grantit të Performancës Komunale (në sistem). Auditimet sociale do të përfshijnë edhe monitorimin e performancës dhe proceset e planifikimit të projekteve në nivel komunal. Projekti do të mbështesë zhvillimin e mjeteve dhe metodologjive të kampionimit, duke përfshirë trajnime për të kryer me sukses auditime të tilla sociale. Auditimet sociale të lartëpërmendura do të financohen nga një pjesë e fondeve të Grantit të Performancës Komunale dhe do të zhvillohen nga organizata të shoqërisë civile. Për këtë, DEMOS do të jetë partner me OSHC-të kryesore.

HYRJE

Ky është një raport përmbledhës i hartuar nga Grupi i Auditimit Social të përbërë nga qytetarë aktiv dhe anëtarë të organizatave të ndryshme nga rajoni i Pejës, të cilët i janë bashkuar Auditimit Social për të monitoruar zbatimin e projektit ‘**Rregullimi i Parkut Karagaq në Pejë**’.

Raporti elaboron metodologjinë e ndjekur nga Grupi i Auditimit Social, veprimet për mbledhjen e të dhënave - duke përfshirë vizitat në terren dhe diskutimet me Kryetarin dhe përfaqësues të Komunës, dhe elaborimin e gjetjeve dhe rekomandimeve.

Auditimi social është bërë i mundur falë mbështetjes së Projektit për Decentralizim dhe Përkrahjen e Komunave (DEMOS), projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Suedia, Norvegjia dhe implementuar nga HELVETAS Swiss Intercooperation-Kosovo.

DEMOS përmes këtij aktiviteti synon të instalojë auditimin social si pjesë të kulturës së monitorimit qytetar për projektet kapitale të zbatuara nga komunitat.



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë periudhës tetor-dhjetor 2022, me mbështetjen nga Projekti DEMOS, Platforma CiviKos ka identifikuar një grup qytetarësh dhe përfaqësuesish të grupeve të organizuara të qytetarëve për të monitoruar zbatimin dhe mbarëvajtjen e investimit kapital në Komunën e Pejës, që ka për qëllim rregullimin e Parkut Karagaç.

Investimi në fjalë, me vlerë EUR 69,879.24

parasheh rregullimin e shtegut përreth liqenit artificial, vendosjen e ulëseve dhe përmirësimin e ndriçimit të parkut.

Gjatë kësaj periudhe dymujore, 21 qytetarë kanë marrë pjesë në një trajnim intensiv dyditor dhe në pesë takime tjera, duke përfshirë takime në terren, dhe takime me Kryetarin dhe përfaqësues tjerë të Komunës së Pejës. Përbërja e Grupit të Auditimit Social është përcaktuar në bazë të ndikimit që ka projekti i Komunës në grupe të ndryshme të popullsisë, e sidomos ato të marginalizuara. Më saktësisht, Platforma CiviKos ka ftuar për të marrë pjesë personat që frekuentojnë rregullisht parkun dhe grupe që mund të jenë frekuentues të parkut në të ardhmen. Një theks i veçantë është vendosur tek pjesëmarrja e grupeve të nënpërfaqësuar, si të rinjë, gra dhe vajza, dhe grupe nga komunitetet joshumicë.

Projekti i Komunës, i kontraktuar përmes procedurës së prokurimit të hapur me emrin **'LOT 1 - Rregullimi i Parkut Karagaç - Pjesa 1'**, sipas Grupit për Auditim Social nuk është zbatuar si duhet në tërësi, për faktin se disa mangësi janë evidentuara nga qytetarët. Si rezultat, investimi në fjalë nuk ka arritur të adresoj në tërësi kërkesat e qytetarëve. Ulëset metalike tashmë të vendosura nuk janë konsideruar të përshtatshme pasi nuk ofrojnë rehati për frekuentuesit e parkut në stinë të ndryshme. Rekomandohet që në të ardhmen ato të modifikohen dhe të kombinohen me dru apo materiale më të përshtatshme. Po ashtu, ndriçimi i vendosur në park nuk funksionon pas orës 23:00, duke mos ofruar siguri për qytetarët që frekuentojnë parkun pas kësaj ore, në veçanti për ata qytetarë që banojnë në afërsi të kësaj zone dhe që e kanë të domosdoshme kalimin përmes parkut.

Gjatë procesit, janë vërejtur indikacione që operatori ekonomik do të përmbushë obligimet e kësaj kontrate, pra do të realizojë intervenimet e parapara me këtë investim, pavarësisht që këto intervenime që janë paraparë me këtë investim nuk konsiderohen si më të përshtatshmet dhe prioritetet për qytetarët. Si rezultat, gjetja kryesore e Grupit të Auditimit Social është që projekti në fjalë nuk u përgjigjet prioritetëve dhe kërkesave të qytetarëve, pasi Komuna nuk është konsultuar mjaftueshëm me ta gjatë dizajnit të këtij projekti kapital. Kërkesë kryesore e qytetarëve për Parkun Karagaç është rregullimi i infrastrukturës rrugore të nevojshme për kategoritë e qytetarëve, sikurse prindërit që kanë fëmijë të vegjël dhe që e frekuentojnë parkun me karroca, apo edhe infrastruktura e nevojshme

dhe përshtatshme për personat me nevoja të veçanta. Po ashtu, sipas qytetarëve, më prioritare në investime të tilla do të ishte përmirësimi i sigurisë në park, duke qenë se një gjë e tillë aktualisht mungon.

Sa i përket gjetjes së Grupit të Auditimit Social se projekti në fjalë nuk u përgjigjet prioriteteve dhe kërkesave më urgjente të qytetarëve, Kryetari i Komunës ka informuar Grupin se janë mbajtur dëgjime publike. Sidoqoftë, Grupi i Auditimit Social mendon se nuk janë bërë përpjekjet e mjaftueshme për të konsultuar qytetarët, pasi në dëgjimet publike të mbajtura nga Komuna nuk janë diskutuar më detajisht investimet sikurse kjo, mirëpo konsultimet kanë qenë të përgjithshme.

Synimi i Grupit të Auditimit Social është që Komuna e Pejës të përmirësojë këto lloj projektesh me rëndësi të madhe për qytetarët. Për këtë arsye, Grupi i Auditimit Social rekomandon që pjesa e betonit përreth ulëseve të punohet sipas standardeve dhe ulëset të jenë të përshtatshme për të gjitha kategoritë e qytetarëve dhe gjatë të gjitha stinëve; Të ketë ndriçim në park edhe pas orës 23:00, duke e rritur kështu sigurinë e kalimtarëve apo vizitorëve të parkut; Të shikohet mundësia e vendosjes së kamerave në park, duke e rritur sigurinë për vizitorët e parkut dhe eliminuar mundësinë e dëmtimit të ulëseve. Përveç kamerave parkut rekomandohet t'i shtohet edhe numri i rojeve, të cilët do të shtonin sigurinë në park. Gjithashtu, qytetarët kanë kërkuar që në të ardhmen, përtej kontratës ekzistuese që ka qenë subjekt i monitorimit, të pastrohen mbetjet inerte tek liqeni, dhe të ndalohet peshkimi ilegal në liqenin e parkut; Të shtohet numri i mirëmbajtësve të parkut për të eliminuar mbeturinat dhe mbajtur parkun më të pastër; Të rregullohet problemi i ujërave të zeza që pas shirave këto ujëra të mos derdhen në liqe; Si dhe të mbillen drunjë duke ruajtur strukturën e njëjtë të drunjëve ekzistues në park.

Komuna e ka mirëpritur angazhimin qytetar në përmirësimin e projektin kapital për rregullimin e parkut të qytetit, mirëpo edhe si shembull i mbështetjes për Komunën në përmirësim të projekte tjera të ngjashme që mund të realizohen në të ardhmen e afërt. Kryetari i Pejës, së bashku me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Financave, ka diskutuar gjetjet e Grupit të Auditimit Social dhe ka ofruar shpjegime për disa nga gjetjet.

Të gjitha palët e përfshira ishin mirënjohëse për ndihmën e ofruar nga Platforma CiviKos dhe DEMOS për të thelluar bashkëpunimin e komunës me qytetarët. Meqenëse projekti në fjalë nuk është përfunduar ende, monitorimi në këtë fazë të projektit i kontribuon dukshëm finalizimit të suksesshëm të tij duke i dhënë mundësinë Komunës të bëjë ndryshimet apo përmirësimet e nevojshme.

Duke u bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e dala nga ky proces, Grupi i Auditimit Social do të vazhdojë të monitorojë progresin e arritur në realizimin e investimit të papërfunduar dhe zbatimin e rekomandimeve që kanë dalë nga ky raport, duke i mbajtur qytetarët të informuar me zhvillimet e reja.

RRETH AUDITIMIT SOCIAL

Sipas udhëzuesit të përgatitur nga DEMOS, auditimi social është njëra nga disa qasjet drejt arritjes së llogaridhënies sociale, përmes një procesi të angazhimit konstruktiv ndërmjet qytetarëve, qeverisë, shoqërisë civile, dhe në disa raste edhe palëve të interesuara të sektorit privat për të vlerësuar sjelljen dhe performancën e zyrtarëve publik, udhëheqësve të zgjedhur dhe ofruesve të shërbimeve që përdorin burimet publike për të ofruar shërbime, për të përmirësuar mirëqenien e komunitetit dhe për të mbrojtur të drejtat e njerëzve.

Auditimi social bazohet në parimet themelore të qeverisjes demokratike dhe të mirë, që do të thotë se procesi është pjesëmarrës, gjithëpërfshirës, transparent, me qasje në informatat e nevojshme dhe se vendimmarrësit dhe politikëbërësit mbahen përgjegjës.

Auditimet sociale nuk duhet të ngatërrohen me auditimet formale dhe financiare, mirëpo ato janë element thelbësor me potencial të plotësojnë auditimet financiare tradicionale për të ndihmuar institucionet publike të krahasojnë performancën e tyre të përgjithshme. Raportet e auditimit social, e në veçanti rezultatet që gjenerohen nga to, mund të përdoren për t'u përfshirë edhe në planet vjetore të auditimit të brendshëm të komunave.

Auditimet sociale ndonjëherë ndërmerren si një ngjarje e vetme, por janë më efektive kur kryhen në mënyrë sistematike si një proces që realizohet në intervale të rregullta. Për të mundur këtë, është thelbësore të ndërtohet një mirëkuptim i përbashkët dhe pronësi reciproke e auditimit social ndërmjet palëve përkatëse të interesuara. Kur janë të suksesshme, proceset e llogaridhënies sociale çojnë në përmirësimin e menaxhimit të burimeve publike, zbatimin e projekteve dhe ofrimin e shërbimeve dhe politikave publike nga të cilat përfitojnë njerëzit, veçanërisht grupet e marginalizuara të shoqërisë. Nëse kryhet rregullisht dhe në mënyrë konstruktive, procesi dhe rezultatet e tij kanë treguar se forcojnë besimin e ndërsjellë ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve qeveritare.

Bashkëpunimi në mes të DEMOS dhe Platforma CiviKos ka për qëllim krijimin e infrastrukturës për auditim social. Meqë është një formë e re e bashkëpunimit në mes të qytetarëve dhe autoriteteve publike, ndërtimi i kapaciteteve është i domosdoshëm. Andaj, ky bashkëpunim ka filluar me pilotim të auditimit social në katër komuna: Pejë, Kamenicë, Lipjan dhe Rahovec. Përmes aktiviteteve në këtë projekt, DEMOS dhe Platforma CiviKos synojnë të instalojnë këtë metodologji tek autoritetet publike në Kosovë dhe shoqëria civile, në mënyrë që të zhvillohet edhe më tutje si praktikë në të ardhmen për projekte të ndryshme kapitale.

HAPAT E PROCESIT TË AUDITIMIT SOCIAL

Platforma CiviKos duke u bazuar në hapat e metodologjisë së auditimit social të DEMOS, ka punuar aktivisht në krijimin e infrastrukturës për monitorimin e katër projekteve kapitale në katër komunat partnere. Gjegjësisht, në Pejë, Kamenicë, Lipjan dhe Rahovec. Metodologjia dhe qasja janë ndërtuar përgjatë një procesi dhe diskutimi të thukët në mes të Platformës CiviKos dhe DEMOS. Pjesët në vazhdim do të shtjellojnë secilin hap që ka formësuar këtë bashkëpunim dhe ka vënë themelet për zhvillimin e konceptit të auditimit social në Kosovë.

METODOLOGJIA

Përzgjedhja e Projekteve dhe Komunave

Një ndër pjesët e rëndësishme të procesit të Auditimit Social e përbën përzgjedhja e komunave dhe projekteve që do të monitorohen nga grupet e auditimit social. Fillimisht, procesit të përzgjedhjes u janë nënshtruar vetëm komunat që kanë përfituar nga granti i performancës. Hapi i parë ka qenë listimi i komunave dhe projekteve në mënyrë që të krijohet një bazë solide për zhvillimin e auditimit social. Hapi fillestar ka qenë i udhëhequr nga DEMOS, që në bashkëpunim me Platformën CiviKos dhe Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL), kanë dërguar te të gjitha këto komuna një kërkesë për shprehje të interesimit/vullnetit për të pilotuar auditimin social. Kësaj kërkesë u janë përgjigjur pozitivisht komunat në masë të madhe, dhe rrjedhimisht ato komuna që kanë shprehur gatishmërinë të bashkëpunojnë për zbatimin e auditimit social janë vendosur në listën e komunave potenciale për ta pilotuar auditimin social.

Pas përfundimit të fazës së parë, DEMOS së bashku me Platformën CiviKos dhe MAPL kanë bërë përzgjedhjen e projekteve duke u bazuar në kriteret si më poshtë:

Statusi i projektit (nëse është në përfundim, mbi 50% e punëve janë të përfunduara, apo është në fazën fillestare);

Targetimi dhe ndikimi i lartë apo i ulët i projekteve për grupet e marginalizuara si gratë, të rinjtë, të moshuarit, personat me nevoja të veçanta dhe komunitetet joshumicë;

Natyra e projektit dhe fusha e ndikimit me prioritet në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe ambientit;

Vlera e grantit e alokuar për realizimin e projektit kapital.

Si rezultat, projektet të cilat kanë marrë më shumë pikë duke u bazuar në kriteret e lartpërmendura janë propozuar për auditim social.

Projektet e përzgjedhura janë si në vijim:

- Rregullimi i Parkut Karagaq në Komunën e Pejës;
- Projekti për shpërndarjen e ujit për fshatrat Hogosht dhe Lisockë në Komunën e Kamenicës;
- Ndërtimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta në Komunën e Rahovecit (Rahovec, Xërxë, Fortesë, Krushë e Madhe, Celinë, Hoqë e Vogël, Opterushë, Malësi e Vogël, Ratkoc, Dejn dhe Qifllak); dhe
- Ndërtimi i Rezervuarit të Ujit dhe Rehabilitimi i Rrjetit të Ujësjiellit në Janjevë në Komunën e Lipjanit.

Komunat të cilat janë përzgjedhur për auditim social janë njoftuar zyrtarisht dhe të gjitha kanë shprehur gatishmërinë për të pilotuar auditimin social për projektet përkatëse të përzgjedhura.

Pas përzgjedhjes së projektit, ka filluar faza vijuese dhe më e rëndësishme e projektit – vendosja e bashkëpunimit me komunat e përzgjedhura dhe themelimi i grupeve për auditim social në terren. Kjo fazë përfshinë ishte edhe pjesa kryesore dhe e domosdoshme për një auditim social të suksesshëm.

- Takimi përgatitor me ekzekutivin komunal: DEMOS së bashku me Platformën CiviKos kanë zhvilluar takime me kryetarët dhe përfaqësues të komunave të Pejës, Rahovecit, Kamenicës dhe Lipjanit për t'i njoftuar së afërmi me procesin e auditimit social, si për shkëmbimin e informatat e nevojshme për projektet në fjalë. Këto takime përveç informimit të institucioneve, kanë shërbyer edhe si një mundësi për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e bashkëpunimit në mes të qytetarëve dhe institucioneve lokale.

- Përzgjedhja e kujdesshme e grupeve të auditimit social: Një nga hapat më sfidues në këtë proces ishte përzgjedhja e grupeve të auditimit social. Platforma CiviKos e ka zhvilluar këtë hap në bashkëpunim me komunat dhe me organizatat anëtare në secilën komunë – meqë CiviKos ka një rrjet të pasur të organizatave jo-qeveritare që operojnë në nivel lokal në të gjithë Kosovën.

Grupet e auditimit social në katër komunat partnere janë përzgjedhur me kujdes të veçantë. Si kriter gjatë përzgjedhjes është marrë parasysh interesimi i qytetarëve për t'u bashkuar me grupin, si dhe ndikimi që ka projekti në jetën e tyre. Rëndësi e veçantë i është kushtuar besimit që anëtarët e komunitetit të jenë sinqerisht të bindur se grupi i auditimit social përfaqëson interesat e tyre. Një element tjetër shumë i rëndësishëm gjatë identifikimit të grupit ka qenë edhe përfaqësimi i grupeve të marginalizuara, apo nën përfaqësuar, duke ju dhënë zë të barabartë gjatë procesit të auditimit social. Platforma CiviKos përveç qytetarëve pjesëtarë të komunitetit, ka përfshirë po ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në nivel lokal. Përfshirja e organizatave është bërë me qëllim të përfitimit nga metodologjia e auditimit social e cila mund të replikohet nga ta në të ardhmen për projekte të ngjashme.

- Trajnimi i grupeve të auditimit social: Meqë auditimi social është koncept shumë i ri në Kosovë, DEMOS ka rekomanduar që menjëherë pas përzgjedhjes së grupeve të auditimit social të fillohet me trajnimin për auditimin social dhe informatave bazë për projektin e përzgjedhur. Në këtë fazë ekipi i DEMOS ka qenë shumë mbështetës duke ofruar asistencë edhe në trajnimin e grupeve të auditimit. Në këtë fazë janë zbërthyer të gjitha projektet e përzgjedhura dhe është krijuar kohezioni në mes të grupit.

- Takimet e rregullta të grupeve të auditimit social: Platforma CiviKos ka lehtësuar takimet e rregullta të grupeve të auditimit social. Gjatë takimeve të rregullta, grupet e auditimit social janë takuar në zonat ku vepron dhe kanë analizuar zbatimin e projektit e po ashtu kanë identifikuar gjetjet specifike.

Me qëllim të vërtetimit të gjetjeve, pranimit të informatave shtesë dhe largimit të keqkuptimeve apo keqinterpretimeve, grupet e auditimit social janë takuar edhe me përfaqësuesit e komunave përkatëse ku ishte planifikuar zbatimi i auditimit social. Grupet e auditimit social kanë zhvilluar edhe takime në terren për të parë së afërmi realizimin e investimeve që janë bërë lidhur me projektet në fjalë dhe për të analizuar nivelin e zbatimit të projektit. E gjitha kjo është bërë me qëllim të evidentimit të gjetjeve gjatë procesit të monitorimit. Përveç vërtetimit të gjetjeve, këto takime kanë synuar ndërtimin e një fryme bashkëpunimi në mes të qytetarëve dhe institucioneve.

- Përgatitja e pyetjeve dhe treguesve të auditimit social: Grupet e auditimit social në katër komunat pilotuese kanë përpiluar pyetje specifike për komunën, kanë mbajtur takime me kryetarët e komunave, dhe drejtorët e drejtorive përkatëse për projektin që është monitoruar. Këto pyetje janë zhvilluar me inputet e qytetarëve në takimet e rregullta përmes një procesi të lehtësuar nga Platforma CiviKos dhe me mbështetjen e ekipit të DEMOS.

Pas takimit me komunat dhe marrjes së informatave, sipas nevojës janë dërguar edhe kërkesat me shkrim për sigurim të informatave apo dokumentacionit shtesë në lidhje me projektin. Pas grumbullimit të informatave dhe dokumenteve relevante janë përpiluar gjetjet kryesore dhe rekomandimet për komunën.

- Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me katër komunat partnere: Me qëllim të formalizimit të bashkëpunimit me komunat pilotuese, Platforma CiviKos ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me katër komunat partnere. Memorandumi i bashkëpunimit formalizon bashkëpunimin në mes të Platformës CiviKos dhe komunave partnere. Me anë të memorandumeve të nënshkruara komunat janë dakorduar që të përpilojnë një plan të veprimit 3-6 muaj pas procesit të monitorimit, atëherë kur grupet e qytetarëve të ketë të përpiluar raportin e monitorimit dhe prezantuar gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Kjo me qëllim për të siguruar përcjelljen dhe progresin e arritur në drejtim të adresimit të gjetjeve dhe rekomandimeve.

PROCESI I AUDITIMIT SOCIAL NË KOMUNËN E PEJËS

Themelimi i Grupit të Auditimit Social në Pejë

Më qëllim të identifikimit të Grupit të Auditimit Social në Pejë, dhe duke marrë parasysh veçantinë e projektit, fillimisht janë identifikuar përfaqësuesit e Këshillave Lokal të Lagjes Karagaç në Pejë. Pas takimit me përfaqësues të Këshillit Lokal dhe prezantimit të konceptit të auditimit social, përfaqësuesit e Këshillit Lokal kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të qenë pjesë e grupit. Gjatë takimit me përfaqësues të Komunës së Pejës janë identifikuar po ashtu edhe Shoqata e Peshkatarëve në Pejë si grup me interes për çështjet e parkut. Për të sjellur diversitet në grup, Platforma CiviKos ka përfshirë edhe dy organizata lokale në Pejë - Let's Do it Peja dhe Era Group. Këto organizata fokus të tyre primar kanë mbrojtjen e ambientit. Anëtarë të tjerë që i janë bashkangjitur Grupit të Auditimit Social në Pejë janë gazetarë lokal, qytetarë vizitorë të parkut dhe sportistë.

Në total, në Pejë janë identifikuar dhe përzgjedhur 21 pjesëtarë të Grupit të Auditimit Social, prej të cilëve pesëmbëdhjetë janë burra dhe gjashtë gra. Pjesëtarët e Grupit duke qenë profesionistë nga lëmi të ndryshme, kanë kontribuar që të zhvillohen diskutime me nuanca. Gjegjësisht, pjesëtarët vinin nga këto profesione:



Menjëherë pas konsolidimit të Grupit të Auditimit Social në Pejë, më datat 1 dhe 2 Tetor 2022, Platforma CiviKos ka mbajtur trajnimin dyditor për Grupin në Pejë. Gjatë këtyre dy ditëve, pjesëmarrësit kanë mësuar rreth funksionimit të nivelit lokal, procesit të monitorimit të kontratave si qytetarë aktiv dhe janë njoftuar me hapat e procesit të auditimit social.

Takimet e Rregullta të Grupit të Auditimit Social në Pejë

Menjëherë pas trajnimit dhe konsolidimit të Grupit, pjesëtarët kanë filluar me takimet e rregullta. Grupi i Auditimit Social në Pejë gjithsej ka mbajtur pesë takime, në mesin e të cilave edhe dy takime me përfaqësues të Komunës së Pejës.

Qëllimi Specifik i Grupit të Auditimit Social në Pejë

Qëllimi specifik i Grupit të Auditimit Social në Pejë ka qenë matja e ndikimit të zbatimit të projektit “Rregullimi i Parkut Karagaq”, me fokus adresimin dhe përfshirjen e kërkesave dhe nevojave të kategorive të ndryshme të qytetarëve, sidomos grupeve të marginalizuara, në intervenimet e projektit, efikasitetin e zbatimit të projektit, si dhe përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.

Indikatorët e performancës të përgatitur nga Grupi i Auditimit Social për projektin e monitoruar janë:

- Organizimi i konsultimit publik me qytetarë të Komunës së Pejës për zbatim të projektit ‘Rregullimi i Parkut Karagaq’;
- Zbatimi në tërësi i projektit sipas kontratës së paraparë;
- Përfundimi i punimeve sipas afateve të parapara me kontratë;
- Realizimi i punimeve duke iu përgjigjur nevojave të kategorive të ndryshme të shoqërisë (grave, të moshuarve, fëmijëve, personave me nevoja të veçanta);
- Kënaqshmëria e Grupit të Auditimit Social rreth cilësisë së punimeve (ndriçimi, ulëset, etj.).

Kërkesat për informacion/dokumente dhe pyetjet e dërguara nga Grupi i Auditimit Social në Pejë te Komuna e Pejës

Duke marrë parasysh natyrën e projektit, Grupi i Auditimit Social për të mbledhur informacion të nevojshëm për procesin, ka kërkuar nga Komuna e Pejës dokumentet dhe informacionet si më poshtë:

- Ftesat dhe procesverbalet që Komuna i posedon për pjesëmarrje të qytetarëve gjatë dëgjimeve buxhetore për projektin “Rregullimi i Parkut Karagaq”;
- A janë vendosur 100 trupat ndriçues të paraparë me kontratë, dhe nëse po, në cilat pjesë të parkut janë vendosur ato?
- Sipas informatave nga Grupi i Auditimit Social ndriçimi nuk punon pas orës 23:00. A mund të na e sqaroni pse ndodh kjo, pasi është vlerësuar se mungesa e ndriçimit pas orës 23:00 ndikon në rritjen e pasigurisë në park gjatë natës? A është menduar ndonjë veprim që të evitohet kjo?
- A janë vendosur të gjitha ulëset e parapara në park? Nëse jo, sa ulëse ende nuk janë vendosur dhe
- kur parashihet të vendosen? Po ashtu, të ofrohet sqarim lidhur me shkaqet dhe faktorët që kanë
- shkaktuar këtë vonesë?
- Cilat janë arsyet e vendosjes së ulëseve metalike? A ka faktor vendimtar çmimi apo ndonjë kriter tjetër?
- Gjatë vendosjes së ulëseve dhe sidomos pjesës së betonit poshtë ulëseve, a është menduar që këto ulëse të jenë të përshtatshme në sezone të ndryshme si dhe për kategori të ndryshme të qytetarëve?
- A është paraparë me këtë kontratë një plan i mirëmbajtjes? Nëse po, të na

sigurohen dokumentet e nevojshme.

- Të ofrohet nga Komuna një pasqyrë e shpenzimeve të deritanishme të projektit për rregullimin e Parkut Karagaq.
- Të ofrohet një plan kohor për finalizimin e projektit si dhe a ka plane Komuna e Pejës që të realizojë ndonjë fazë pasuese për rregullimin e mëtutjeshëm të Parkut Karagaq? Nëse po, të sigurohen dokumentet e nevojshme që dëshmojnë për këtë planifikim të Komunës.
- Cilat çështje apo probleme është planifikuar të rregullohen përmes këtij investimi dhe nevojave të cilit komunitet në veçanti iu ka përgjigjur Komuna përmes këtij investimi?
- A është menduar të pastrohen mbetjet inerte në liqe pas përfundimit të kubëzimit?

RRETH PROJEKTIT

Projekti	LOT 1 - Rregullimi i Parkut Karagaq - Pjesa 1, me numër identifikues 635-21-3456-5-2-I dhe numër të brendshëm 635/21/046/521
Çmimi total i punëve në kontratë	EUR 69,879.24
Statusi i kontratës	E pa përfunduar

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Pejës

Zbatues: O.E “SKY LINE” SHPK nga Peja, me numër të biznesit 810089153

Ky projekt bashkëfinancohet sipas marrëveshjes ndërmjet MAPL, Komunës së Pejës dhe Helvetas Swiss - i përfaqësuar nga projekti DEMOS, i përcaktuar sipas vendimit të Komisionit të Grantit për Performancën Komunale (GPK).

GJETJET KRYESORE



Ulëset e metalit të vendosura në park nuk ofrojnë komoditet - Pjesa e betonit e vendosur përreth ulëseve nuk është e përshtatshme dhe është shumë e lartë. Si pasojë, ato nuk ofrojnë qasje dhe shfrytëzim të lehtë për të gjitha grupet e qytetarëve. Gjithashtu, ulëset metalike të vendosura nuk janë të përshtatshme për park, pasi nuk ofrojnë rehati për stinë të ndryshme. Metali, megjithëse është një material i fortë, nuk është i përshtatshëm gjatë stinëve të ftohta.



Mungesa e ndriçimit në park pas orës 23:00 - Ndriçimi i vendosur në park nuk funksionon pas orës 23:00, duke mos ofruar siguri tek qytetarët frekuentues të parkut apo kalimtarët e rastit. Për këtë gjetje, Kryetari i Komunës ka informuar Grupin se mungesa e funksionimit të ndriçimit pas orës 23:00 vjen si pasojë e kërkesës së KEDS për kursim të energjisë. Ky orar mund të ndryshojë varësisht prej situatës energjetike në vend.



Mungesa e ndriçimit tek pjesa e fontanës - Tek pjesa e fontanës nuk ka ndriçim të mjaftueshëm. Gjithashtu, nuk ka ndriçim të mjaftueshëm nga Halla e Sporteve Karagaq deri te fusha e futbollit.

Pavarësisht që nuk është e paraparë me kontratë, Grupi i Auditimit Social në Pejë ka identifikuar edhe këto gjetje që do t'i kontribuonin përmirësimit të përvojës së qytetarëve në park:




Mungesa e infrastrukturës së nevojshme për grupet e marginalizuara - Grupi i Auditimit Social vlerëson që me investimin e realizuar, projekti në fjalë nuk u përgjigjet prioriteteve dhe kërkesave më urgjente të qytetarëve të Komunës së Pejës, sidomos grupeve të marginalizuara që frekuentojnë parkun. Në këtë aspekt, në Parkun Karagaq vazhdon të mungojë infrastruktura e nevojshme rrugore për prindërit që kanë fëmijë të vegjël dhe që e frekuentojnë parkun me karroca, e po ashtu ka mungesë të infrastrukturës për personat me nevoja të veçanta. Specifikisht, infrastruktura rrugore e përshtatshme për ta dhe prania e pjerrinave që mundësojnë qasjen dhe kalimin me të lirshëm. Aktualisht, pjesa dërrmuese e parkut që përdoret për lëvizjen e qytetarëve është e shtruar me zhavorr.



Mbetjet inerte në liqe të pa pastruara - Nuk janë pastruar mbetjet inerte në liqe, më saktësisht nuk janë larguar kubëzat e vjetra të cilat janë hedhur në liqe.



Mungesa e sigurisë së plotë në park - Parku, përkundër gjithë punimeve e realizuara, nuk ofron siguri të plotë për vizitorët. Vlen të ceket edhe mungesa e kamerave në park që ndikon aspektin e sigurisë.



Problemet me ujëra të zeza - Janë evidentuar probleme me ujërat e zeza pas shiut.



Parku nuk është i mbrojtur pasi dëmtohet shpesh.

REKOMANDIMET

- Komuna e Pejës të sigurohet që pjesa e betonit përreth ulëseve të punohet me standarde, dhe të jetë e përshtatshme për të gjitha kategoritë e qytetarëve. Duhet të sigurohet që lidhja e ulëses me betonin të bëhet në atë mënyrë që të jetë e pamundur heqja e ulëses nga betoni.
- Të shikohet mundësia e modifikimit të ulëseve të hekurit, për të bërë këto më komode për qytetarët për të gjitha stinët;
- Të mbahet ndriçimi në park edhe pas orës 23:00 duke e rritur sigurinë e kalimtarëve apo vizitorëve të parkut. Të vendoset ndriçim shtesë tek fontana e parkut. Gjithashtu, të vendoset ndriçim shtesë nga Halla e Sporteve Karagaq deri tek fusha e futbollit;
- Grupi i Auditimit Social rekomandon që Komuna të shtojë përpjekjet për përfshirje të qytetarëve gjatë dizajnit të projekteve, dhe të bëhet përfshirja sa më e madhe e tyre në dëgjime buxhetore/konsultime publike. Kjo mund të realizohet duke përdorur mjete komunikimi si rrjete sociale, por edhe forma tradicionale si letra fizike që mund të ndahen përmes postës, për të rritur pjesëmarrjen;
- Të shikohet mundësia e vendosjes së kamerave në park, duke e rritur kështu sigurinë për vizitorët e parkut dhe eliminuar mundësinë e dëmtimit të ulëseve;
- Të shikohet mundësia e vendosjes së një fontane te liqeni, që gjithashtu do të furnizonte liqenin me ujë;
- Të pastrohen mbetjet inerte te liqeni, dhe të ndalohet peshkimi ilegal në liqenin e parkut;
- Të shtohet numri i mirëmbajtësve të parkut për të mbajtur parkun më të pastër;
- Të rregullohet problemi i ujërave të zeza, që pas shirave këto ujëra të mos derdhen në liqen;
- Të mbillen drunjë duke ruajtur strukturën e njëjtë të drunjve në park;
- Të angazhohen më shumë roje të parkut, të cilët e mbrojnë parkun nga dëmtimet.

LISTA E PËRBËRJES SË GRUPIT TË AUDITIMIT SOCIAL

	Emri dhe Mbiemri	Organizata/Profesioni
1	Eroll Grapci	SHPSR Trofta Pejë/ Producent
2	Lulzim Murati	SHPSR Trofta Pejë/ Guidë Malore
3	Aurela Gjokolli	Let's Do It Peja
4	Valdrin Daci	Gazetar
5	Ilir Osmanaj	Gazetar
6	Linda Gjakova	Gazetare
7	Fatos Kartallozi	Jurist
8	Mentor Bojku	Ekonomist
9	Mevlyde Popovci	Doktor
10	Zamire Sapungjiu Selimi	Ekonomist
11	Ilirjana Kastrati	OJQ ERA/ Juriste
12	Adelina Kastrati	OJQ ERA/Juriste
13	Kastriot Blakaj	Profesor i Informaconit dhe Teknologjisë
14	Remzi Krasniqi	Profesor
15	Besmir Nikqi	Sportist
16	Bujar Kelmendi	PIktor
17	Bejhan Krasniqi	Kryetar i Këshillit Lokal, Karagaç
18	Nol Krasniqi	Sportist
19	Gresa Bakraqi	Sportiste
20	Riza Blaku	KBL Karagaçi/ Biolog

